



Planifikimi Urbane me Pjesëmarrje

Konteksti i projektit

Instituti i Kërkimeve Urbane është kontraktuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri për të zbatuar projektin "Planifikimi Urban me Pjesëmarrje". Pas përzgjedhjes së qeverisë vendore që do të përfshihej në këtë projekt, që është Kavaja, IKU ka filluar me zbatimin e projektit.

Aktivitetet e projektit

Instituti i Kërkimeve Urbane e zbatoi këtë projekt nëpërmjet aktiviteteve që nxisin/rrisin kërkesën për një qeverisje më të mirë dhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset e qeverisjes në Shqipëri. Planifikimi Urban me Pjesëmarrje (PUP) në Shqipëri, është hartuar me qëllim që të përmirësojë qeverisjen vendore dhe besimin në Shqipëri duke:

- (i) ngritur kapacitetet e zyrtarëve lokal dhe grupeve qytetare për t'u përfshirë në konsultime që janë të fokusuara dhe orientuar drejt zgjidhjes së problemeve të komunitetit dhe
- (ii) prezantimi i mekanizmave afatgjatë dhe afatshkurtër për institucionalizimin e zërit qytetar në vendimarrje në qeveri.

Objektivi Kryesorë

Objektivi afatgjatë është krijimi i mundësive për përfshirje qytetare në vendimarrje. Aktivitetet që realizohen gjatë Planifikimit Urbane me Pjesëmarrje testojnë mekanizmat që rrisin pjesëmarrjen qytetare në

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.



vendimarrje në procesin e planifikimit urban dhe zbatimit në Shqipëri. Rezultati i pritshëm nga metoda e planifikimit urban me pjesëmarrje është që t'u ofrojë qytetarëve mundësi që të marrin pjesë në procesin e vendimarrjes së qeverisjes vendore gjatë planifikimit urban dhe të testojë mekanizmat që nxisin këtë pjesëmarrje.

Fazat e projektit

Faza e parë perfshiu Mobilizimin dhe Angazhimin e Akotrëve Kryesore. Gjate kesaj faze u identifikuan 8 grupe:

- Grupi i shërbimeve;
- Grupi i mjedisit;
- Grupi i ekspertëve Ligjore;
- Grupi i ekspertëve të urbanistikës

dhe ndërtimit;

- Grupi i Biznesmenëve;
- Group i shoqërisë civile;
- Grupi i trafikut rrugor

Faza e dytë kishte të bënte kryesisht me grumbullimin e informacionit, ideve, interesave, sugjerimeve, nevojave dhe çështjeve të grupit të interesave.

Gjatë fazës së tretë u realizua analizimi i gjithë informacionit dhe u përgatit një draft për zonimin funksional të qytetit.

Gjatë fazës së katërt u bë finalizimi i draftit, u hartuan disa mekanizma monitorimi dhe vlerësimi, u përmbledhen mesimet e nxjerra gjatë procesit dhe u realizua raporti finale.

Kriteret

- Duke u bazuar në disa kriteret si:
- (a) dëshira politike e qeverisjes vendore për të marrë pjesë;
 - (b) ekzistenca e grupeve të organizuara të komunitetit që përfshihen në aktivitetet e qeverisjes vendore;
 - (c) dëshira e qeverisjes vendore për t'u ofruar qytetarëve informacion dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre;
 - (d) dëshira e qeverisjes vendore për t'u ofruar qytetareve hapësirë për takimet e hapura në procesin

e planifikimit urban;

(e) qeveri vendore që përfshin komunitetin në takimet e këshillit bashkiak, si dhe në procesin e buxhetimit;

(f) vende ku ka prezencë të donatorëve të tjerë që mund të krijojnë mundësi për sinergji; bashkia e Kavajës u zgjodh ndër bashkitë e tjera për të zbatuar këtë projekt. Marrëveshjet e mirëkuptimit midis partnereve dhe qeverisë vendore u nënshkruan në mënyrë që të siguroheshim që të dy palët të ishin dakort për objektivat dhe zbatimin e projektit.

Zbatimi

Roli i Institutit të Kërkimeve Urbane (IKU) ishte asistencë teknike. Ekspertët e IKU-t në bashkëpunim me ekspertët e bashkisë së Kavajës ngritën një komitet drejtues me pjesëmarrjen e Bashkisë, Këshillit Bashkiak, Departamentit të Urbanistikës në Bashki, Shoqërisë Civile dhe aktoreve të tjerë kryesore.

Nje nga komponentet kryesore të zbatimit të fazës së parë ishte fushata e informimit. Aktivitetet e organizuara gjatë kësaj faze kishin lidhje me tepër me tërheqjen e vëmendjes qytetare dhe shtimin e interesit të tyre për përfshirje në mbledhjet e hapura në mënyrë që të jepnin kontributin e tyre në procesin e planifikimit urban. Gjatë kësaj faze u organizuan aktivitete të ndryshme si p.sh.:

- Njoftime publike nëpërmjet

kanalit televizivë lokal 2A mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së komunitetit në mbledhjet e hapura që do organizoheshin për gjashtë lagjet e Kavajës.

- Një formë tjetër informimi ishte dhe vizitat nëpër shtëpi.
- Në gazetën lokale të Forumit Qytetarë “Komuniteti dhe Qeverisja” u botua një artikull që jepte informacion mbi projektin dhe aktivitetet që do organizoheshin në kuadër të projektit.
- Gjithashtu, po në të njejtën gazetë u botuan dhe artikuj të ndryshëm mbi opinionin e qytetarëve për zbatimin e këtij projekti.

Mbas këtij takimi u organizuan tre takime të hapura me përfaqësues të gjashtë lagjeve të qytetit të Kavajës. Edhe gjatë këtyre takimeve u bë një prezantim i shkurtër i projektit, por koha më e madhe i'u la sugjerimeve të qytetarëve përderisa qëllimi i takimeve të hapura ishte që të grumbulloheshin idetë, mendimet, sugjerimet, rekomandimet dhe problemet që parashtronin qytetarët në lidhje me të ardhmen e zhvillimit të qytetit. Bashkia tashmë ka një instrument modern planifikimi afatmesëm, “Rregulloren e Zonimit Funkcional” si dhe “Harten e Zonimit Funkcional”, të cilat do të udhëheqin bashkinë dhe komunitetin e Orikut drejt një zhvillimi urban më eficient dhe të

qendruar në pesë vitet e ardhshme. Instrumenti i ri i planifikimit lehtëson bashkinë dhe qytetarët për të vlerësuar dhe ekzekutuar lejet e zhvillimit të cilat harmonizojnë interesat e qytetarëve dhe sigurojnë zhvillimin me planifikim të qytetit.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Ambasaden e Shteteve të Bashkuara të Amerikës/Komisioni i Granteve të Vogla për Demokracinë

KOHËZGJATIA:

Shtator 2006 – Shkurt 2007

PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia Kavajë

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.